



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.09 prot.

Himarë, më 09.07 . 2025

ZBARDHJE E PROTOKOLLIT NGA ORGJINALI I MBLEDHJES JASHTË RADHE TË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË.

Sot më datë 09.07.2025 zhvillohet mbledhje jashtë radhe e Këshillit Bashkiak, mbledhja është kërkuar nga Kryetari Bashkisë dhe është thirrur nga Kryetari këshillit. Mbledhje e hapur . Ora 10:00.

Të ftuar kryetari Bashkisë, nënkryetarët e Bashkisë, drejtoritë, administratorët e njësive , kryetarët e fshatrave .

Marrin pjesë këshilltarët :

Afrovita Dhimojani, Dhimitër Kapaj, Nikolin Laska , Silva Burbo, Thëllëza Kokaveshi, Artionil Shirokaj, Qirjako Mërkuri, Artan Bala, Fuat Mati, Lenica Kocani, Elisabeta Lamaj, Aleks Llazari , Mirka Gjiçali, Timoleo Gërdhuqi, Gjergji Iliadhi, Milto Nika . Mungojnë : Maks Vlasi, Nertila Husi, Loreta Isufi, Thodhori Foto, Miltiadh Prifti .

Hap mbledhjen kryetari këshillit. Lexohet ligjshmëria e vendimeve të muajit të kaluar.

Jeni dakort me rendin e ditës? Znj . Silva Burbo : me leje kryetar , në mbledhjen jashtë radhe nuk ka pikë të ndryshme për diskutim, po , Kryetari, është lapsus i sekretares. Në rregull.

Pika e parë .

Për miratimin e kahut të lëvizjes, orarit të lëvizjes dhe kufizimit të qarkullimit në disa akse të brendshme të mjeteve automobilistike në qytetin e Himarës.

Z. Timoleo Gërdhuqi: me leje? Ne si komision u mbledhëm dhe shqyrtuam materialin por si anëtarë nuk ramë dakort të gjithë, duam një shpjegim më të detajuar nga drejtoria përkatëse.

Merr fjalën kryetari Bashkisë Përsëndetje! Këtë mbledhje e kam kërkuar për mbarëvajtjen e sezonit turistik, në bazë të kërkesës që i është bërë drejtorisë përkatëse si specialist dhe në bashkëpunim me ekspertin e komisarit dhe në bashkëpunim me urbanistikën kanë marrë në shqyrtim qarkullimin e Himarës dhe menduam se kjo është më e mira për këtë sezon .

Z. Afrovita Dhimojani: A ka patur propozime të tjera nga publiku ? Ky vendim ka hyr në fuqi që në datë 1 korrik dhe sot na vjen për miratim në këshill, si del si mendim nga ju apo është bërë në mënyrë formale edhe pastaj e sillni për miratim këtu? Sqaron drejtori juridik: Meqë jemi në sezon turistik dhe për shkak të fluksit të qarkullimit menduam t'a çonim në zbatim dhe

pastaj t'a sjellim në këshill. Z. Afrovita Dhimojani : Si ka hyr në fuqi, si e keni zbatuar urdhëron se keni çuar tabelat, ndryshim sinjalistikash, qytetarët duhet të ishin informuar për këtë , ndërkohë ju keni proceduar qytetarët të cilët nuk kanë patur djemi për këtë vendim. Sqaron drejtori juridik .

Z. Afrovita Dhimojani replikon me kryetarin e Bashkisë.

Kryetari Bashkisë: Është kompetencë e imja dhe vendimi është i juaj , tabelat nuk kanë përfunduar akoma , kemi mendime, sugjerime , nga qytetarët për një shesh rrotullimi dhe mund të shikojmë një ndryshim tek Spahijo deri tek hyrje në Potam do ta shqyrtojnë nëse jeni kundër. Por nuk mund të pengoni insistimin e kryetarit për shërbim më të mirë ndaj qytetarit , kjo është e mirë për imazhin e bashkisë , për lehtësuar qarkullimin e banorëve. Jemi ju që e vendosni edhe afatin sezonal apo vjetor.

Kryetari Këshillit : Ju lutem të ruajmë etikën dhe të zbatojmë rregulloren e këshillit ! Z. Fuat Mati: Duhet të jemi të qetë, nuk jemi për politikë , nëse është për të mirë të komunitetit hajde e vendosim bashkë , qarkullimi është problem për të gjithë bashkinë , për këtë projekt nuk shoh ndonjë tendencë me të keq, ose të pastrohet rruga nga parkimet e ta lëmë dy kalimshe . Znj.

Silva Burbo: ne si grup Këshilltarësh morëm takim me kryetarin për këtë çështje dhe dolëm në konkluzion se do të bëhej një testim në qarkullim, z. Kryetar a u bë? Rruga nuk duhet të zihet për parkimet sepse është e ngusht sidomos në qendër, të lirohet të jetë dykalimshe edhe në guma të ngelet njëkalimshe , specialistët të dalin në terren sepse jemi qytetar dhe ndikohemi drejtpërsëdrejti nga ky vendim dhe bizneset kanë rënë 30% nga ky vendim . Ju lutem hiqni parkimet nga ana e rrugës. Kryetari Bashkisë : Ka patur më parë parkimet nga ana e rrugës?

Po: Këshilli. Kryetari : Po si ka mundësi që sot bëhet kaush kur rruga është dykalimshe ? Nëse propozoni që të mos ketë parkimet në Himarë, i hiqni, merrni vendim ! Mbas vendimit do të ketë shtesa të tabelave . Znj.Silva Burbo: Ne u dhamë një propozim por ju na keni sjellë harta sot që nuk janë të propozimit tonë . Z. Kapaj : po ju kam gjetur te Kryetari për këtë propozim , por z.Aleks nuk duhet marrë personal për secilin biznes por do marrë vendim në të mirën e përgjithshme për Himarën ta miratojmë , le të ndërhyjmë për gjëra të vogla. Z.Aleks Llazari : Ju këshilli i mëparshëm nuk keni miratuar një rrugë më përpara. Z. Qirjako Mërkuri : Le ta lëmë në vazhdimësi, të bëhet një verifikim , të testohet edhe mendimi njerëzve, për mua më pëlqeu lëvizja , qarkullimi i mjeteve, le të vazhdojë si proces që është nisur.

Z. Timoleo Gërdhuqi : Parkimet janë kompetencë e këshillit , dhe ne i kemi miratuar parkimet me pagesë, papagesë , ne nuk marrim kompetencat e kodit rrugor , këtë e kanë specialistët, ne mund të miratojmë vetëm njërin nga dy variantet që na sjell specialisti . Kryetar parkimet i kemi vendos ne dhe asgjë të mos ndryshosh ! Ne kemi në dorë për këtë vendim të jetë sezonal apo vjetor. Znj. Mirka Gjiçali: Te spitali ka problem me qarkullimin.

Kryetari Këshillit : E hedhim në votim? Merr fjalën banor i bashkisë: Për tabelat, ndryshimi tyre nuk jam dakort, problem kryesor është te big market, furnizimi i tyre , i bie të mbajnë më gjatë , të bëjnë rrotullimin , ka vështirësi qarkullimi.

Kryetari Bashkisë: Ky është qëllimi , për lehtësim qarkullimi.

Banor i bashkisë : Që nga centrale deri te kthesa e Dume duhet të pastrohet nga makinat, të dalin ekspert të bëjnë hetimet.

Znj. Silva Burbo : Propozova qëndra deri në Guma të bëhet dykalimshe dhe mos të ketë parkimet.

Kryetari Këshillitv: Vazhdojmë e hedhim në votim , sa janë pro që ky vendim t'i miratohet sezonal?

Miratohet vendimi për ndryshimin e sinjalistikave dhe qarkullimin e mjeteve në Himarë me trembëdhjetë (13) vota pro, tre (3) kundër , zero (0) abstenim . Vendimi nr.34.

Pika e dytë e rendit të ditës.

Për miratimin e fondit të emergjencës për përballimin e situatave të krijuara nga zjarrvënja në territorin e Bashkisë të Himarës.

Kryetari Këshillit :- Ky material nuk ka kaluar në komision , pasi mungonin anëtarët , nëse është dakort këshilli ta shqyrtojmë? Po: këshilltarët . Sqaron drejtori Laert Mezani : Nëse miratohet si vendim do ti vendosim vlerat në zbardhje.

Znj. Thëllëza Kokaveshi : Shuma është vetëm për dy pika , nuk janë për pagat e punonjësve . Sqaron z.Laert Mezani: pagdhendur shpërblimet janë buxheti jonë, është grande .

Sqaron Kryetari Bashkisë : fondin e emergjencës nuk duhet t'a kthejmë mbrapsht , ta djegim , duhet t'a shfrytëzojmë . Z. Laert Mezani: këtë fond që ju kemi përcjellë vjen nga qeverisja vendore . Znj. Afrovita Dhimojani : Sa është fondi i bashkisë? Z.Laert Mezani (drejtor i financës) 4% zë në buxhet fondi i emergjencës. Znj. Afrovita : Po për çfarë është parashikuar ky fond ? Për blerjen e dronëve , zjarrfikësve, automjeteve ...

Kryetari Këshillit : e hedhim në votim . Sa janë pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet vendimi nr. 35 , për fondin e emergjencave , për përballimin e situatave të krijuara nga zjarrvënja në territorin e Bashkisë të Himarës me trembëdhjetë (13) vota pro , një (1) abstenim (Afrovita Dhimojani) zero (0) kundër. Znj. Silva Burbo është larguar nga mbledhja pasi u miratua pika e parë e rendit të ditës.

Kryetari i këshillit mbyll mbledhjen dhe nënshkruan protokollin e mbledhjes.

Zbardhur nga protokolli origjinal ,

Sekretari

Elena Memushaj

Me respekt,

Sekretari
Elena Memushaj

A handwritten signature in dark ink, appearing to read 'Elena', with a long, sweeping horizontal stroke extending to the right.